



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 969 Prot.

Tiranë, më 06.05 .2026

VENDIM QARKULLUES

Nr. 70 datë 06.05 .2026

**“PËR
MIRATIMIN E PROPOZIMIT TË SHITESAVE DHE NDRYSHIMEVE TË
RREGJISTRIT TË PARASHIKIMEVE TË PROKURIMEVE PUBLIKE (NGA
BUXHETI DHE TË ARDHURAT) PËR VITIN 2026, NË UNIVERSITETIN E
SPORTEVE TË TIRANËS”**

Mbështetur në nenin 38, neni 108, të Ligjit nr. 80/2015, “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, në ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në ligjin nr.10296, datë 08/07/2010 “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, në mbështetje të Ligjit nr. 162/2020 “Per prokurimin Publik”, i ndryshuar, në VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Mbi Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar të Udhëzimit me nr. 9, datë 20.3.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” të ndryshuar, të Vendimit me nr. 1 date 08.01.2026 të Bordit të Administrimit mbi “Miratimin e detajimit te grantit të mësimdhënies për vitin 2026 te UST-së”, të Vendimit të Rektoratit me nr. 32 datë 16.02.2026 “Për miratimin e propozimit të RPPP nga buxheti dhe të ardhurat për vitin 2026”, të Vendimit të Senatit Akademik me nr. 32 datë 23.02.2026 “Për miratimin e propozimit të RPPP nga buxheti dhe të ardhurat për vitin 2026”, të Vendimit të Bordit të Administrimit me nr. 15 datë 25.02.2026 “Për miratimin e RPPP nga buxheti dhe të ardhurat për vitin 2026 në UST”, në vijim të shkresës së Ministrisë së Arsimit me nr. 2720 prot datë 08.04.2026 “Dërgohen fondet e miratuara të shpenzimeve kapitale për vitin 2026-2028”, të Udhëzimit të Përbashkët të Ministrisë të Punëve të Brendshme dhe Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë nr. 70, datë 30.03.2026, në Statutin e UST-së, neni 25, në Relacionin me nr. 826 prot., datë 20.04.2026, në Vendimin e Rektoratit nr.69, datë 22.04.2026, Senati Akademik me Vendim Qarkullues të datës 06.05.2026,

V E N D O S I:

1. Të miratojë propozimin për shtesa dhe ndryshime të Rregjistrit të Parashikimeve të Prokurimeve Publike për vitin 2026, në Universitetin e Sporteve të Tiranës (nga buxheti dhe të ardhurat), sipas tabelës bashkëngjitur.

2. Ky Vendim i përcillet për miratim Bordit të Administrimit të UST-së.
3. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

PROF. DR. AGRON KASAP





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
ADMINISTRATORI

Nr. 026 Prot.

Tiranë, më 20.09 2026

Lënda: Relacion mbi shtesa dhe ndryshime në Regjistrin e Parashikimeve të Prokurimit Publik për vitin 2026.

REKTORATIT TË UST-së

SENATIT AKADEMIK TË UST-së

BORDIT TË ADMINISTRIMIT TË UST-së ✓

KËTU

Të nderuar!

Në zbatim të Ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor IAL, në Republikën e Shqipërisë", neni 38, 40, 49, 108, në ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, të ligjit nr. 87/2025 "Për buxhetin e vitit 2026, të ligjit nr. 10296, datë 08/07/2010 "Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", i ndryshuar, të Ligjit me nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", neni 3, pika 7, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, të Udhëzimit me nr. 9, datë 20.3.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit" të ndryshuar, të Vendimit me nr. 1 date 08.01.2026 të Bordit të Administrimit mbi "Miratimin e detajimit të grantit të mësimdhënies për vitin 2026 të UST-së", të Vendimit të Rektoratit me nr. 32 datë 16.02.2026 "Për miratimin e propozimit të RPPP nga buxheti dhe të ardhurat për vitin 2026", të Vendimit të Senatit Akademik me nr. 32 datë 23.02.2026 "Për miratimin e propozimit të RPPP nga buxheti dhe të ardhurat për vitin 2026", të Vendimit të Bordit të Administrimit me nr. 15 datë 25.02.2026 "Për miratimin e RPPP nga buxheti dhe të ardhurat për vitin 2026 në UST", janë parashikuar fonde nga buxheti dhe të ardhurat, të cilat janë parashikuar në detajimin sipas Regjistrin të Parashikimeve të Prokurimeve Publike për vitin 2026.

Në vijim të shkresës së Ministrisë së Arsimit me nr. 2720 prot datë 08.04.2026 "Dërgohen fondet e miratuara të shpenzimeve kapitale për vitin 2026-2028", të Udhëzimit të Përbashkët të Ministrit të Punëve të Brendshme dhe Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 70, datë 30.03.2026, "Për miratimin e tarifave të reja të shërbimeve që u ofrohet subjekteve publike, nga Shoqëria "Illyrian Guard" ShA", botuar në fletoren zyrtare nr.67-2026, datë 02.04.2026, në mbështetje të Ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin Publik" i ndryshuar, neni 3, pika 7, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar, si dhe si pasojë e ndryshimit të nevojave dhe shtimit të kapaciteteve infrastrukturore

përmes një terreni të ri sportiv, për të cilën kanë lindur nevoja shtesë operative dhe mirëmbajtjeje, kërkohet shtesë dhe ndryshime në Regjistrin e Parashikimeve të Prokurimeve Publike për vitin 2026. Shtesat dhe ndryshimet janë për zërin 602 shpenzime korente (nga buxheti), dhe për zërin 2310000 investime nga të ardhurat dytësore dhe nga buxheti të cilat po i trajtojmë më poshtë vijon:

1. Shtesë në RPPP për vitin 2026 nga buxheti për zërin e investimeve 2310140 në shumën 5,942,200 lek .

Universiteti i Sporteve të Tiranës në vitin 2025 pas aplikimit në AKKSHI ka fituar projektin me titull : (US - Laboratori i Diagnostikës dhe Optimizimit të Shëndetit). Pas miratimit të fondeve me shkresë të MF me nr. 8036 prot., datë 27.05.2025, përcjellë me shkresë të MA me nr. 3000/2 prot., datë 30.05.2025 në shumën 22,622,123 lekë me kod projekti 18BD985, të cilat ishin të shtrira për vitin 2025 në shumën 17,561,213 lek dhe diferenca tjetër për vitin 2026, u vijua me procedurën e prokurimit të ndarë në tre Lote. Nga procedura e prokurimit dy Lote u realizuan dhe janë likuiduar plotësisht pas përfundimit dhe marrjes në dorëzim të mallrave, ndërsa Loti i tretë dështoi edhe pse u shpall dy herë radhasi, nga Njësia e Prokurimit pranë Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse, pasi nuk kishte operatorë ekonomikë të suksesshëm. Për këtë arsye i kërkuam MA pakësim fondesh për vitin 2025.

Që ky projekt të përfundoj totalisht dhe të arrihet qëllimi i projektit, me shkresë nr. 141 prot., datë 19.01.2026, të Administratorit ju drejtuam Ministrisë së Arsimit për planifikimin e këtyre fondeve për vitin 2026 në shumën 5,942,200 lek, nga fondet për shpenzime kapitale, fonde të cilat MA na i rimbursoi me shkresën nr. 2720 prot., datë 08.04.2026.

2. Shtesë në RPPP për vitin 2026 nga buxheti në zërin 6020200 "Materiale për pastrim, dezinfektim, për ngrohje dhe ndriçim", nga vlera 720,000 lek kemi kaluar në vlerën 1,000,000, pra kemi një rritje me 280,000 lek.

Argumentimi: Rritja e fondit lidhet drejtpërdrejt me përfundimin dhe vënien në funksion të projektit "Rikonstrukcion i fushës së futbollit dhe pistës së atletikës", çka ka sjellë shtim të sipërfaqeve funksionale dhe për rrjedhojë, rritje të kërkesës për shërbime mirëmbajtjeje.

Analiza e kryer nga Sektori i Shërbimeve Mbështetëse evidenton një rritje të volumit të shërbimeve për pastrim, dezinfektim dhe ndriçim, si dhe një rritje proporcionale të konsumit të materialeve përkatëse. Përlllogaritja e fondit është bazuar në vlerësimin e nevojave të përditësuara operative, duke synuar garantimin e standardeve higjieno-sanitare dhe funksionale në përputhje me kërkesat e veprimtarisë arsimore dhe sportive të institucionit.

3. Pakësim në RPPP për vitin 2026 nga buxheti 6025300 "Shpenzime për mirëmbajtjen e objekteve ndërtimore (Xhama. Bojra për ambiente të jashtme e të brendëshme, kangjella, rërë kuarci, etj.)" nga vlera 3,840,000 lek kemi kaluar në vlerën 1,200,000, lekë, pra kemi një zbritje me 2,640,000 lek.

Argumentimi: Ndryshimi në Regjistrin e Prokurimeve për këtë objekt konsiston në rishikimin në ulje të fondit limit dhe përshtatjen e procedurës së prokurimit, në përputhje me natyrën reale të nevojës dhe kuadrin ligjor në fuqi.

Autoriteti kontraktor ka detyrimin të sigurojë planifikim mbi bazën e nevojave reale dhe të argumentuara, duke respektuar parimin e proporcionalitetit në përcaktimin e fondit dhe llojit të procedurës së prokurimit.

Nga shqyrtimi teknik i kryer nga Sektori i Shërbimeve Mbështetëse, rezulton se infrastruktura e re ndodhet në gjendje optimale funksionale dhe nuk paraqet nevojë për ndërhyrje mirëmbajtjeje me karakter të thelluar apo me kosto të lartë në fazën aktuale të shfrytëzimit. Nevojat ekzistuese kufizohen në ndërhyrje rutinë dhe periodike me volum dhe kosto të ulët si psh; bojra, xhama, materiale ndërtimore, lysterje, kangjella, çka reflekton një reduktim të kërkesave për mirëmbajtje.

4. Shtesë në RPPP për vitin 2026 nga buxheti në zërin 6022008 për shumën 1,181,526.91 lekë.

Argumentimi: Në zbatim të Udhëzimit të Përbashkët të Ministrisë të Punëve të Brendshme dhe Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë nr.70, datë 30.03.2026, "Për miratimin e tarifave të reja të shërbimeve që u ofrohet subjekteve publike, nga Shoqëria "Illyrian Guard" ShA", botuar në fletoren zyrtare nr.67-2026, datë 02.04.2026, në e-mailin e datës 03.04.2026 nga Shoqëria "Illyrian Guard" ShA", vlera e kontratës me nr.2920/1 prot., datë 31.12.2025 nga përlogaritet e Drejtorit të Financës dhe Buxhetit shkon nga 6,302,911.1 lekë në vlerën prej 7,484,438.02 lekë pra me një efekt financiarë në rritje prej 1,181,526.91 lekë.

5. Shtesë në RPPP për vitin 2026 nga buxheti në zërin 6021010 "Shpenzime për prodhim dokumentacioni specifik", nga vlera 240,000 lek në kemi kaluar në vlerën 1,058,473, pra kemi një rritje me 818,473 lekë.

Argumentimi: Rritja e fondit për zërin "Shpenzime për prodhim dokumentacioni specifik", është e domosdoshme si pasojë e rritjes së volumit të punës në Sekretari, veçanërisht në lidhje me administrimin e dokumentacionit zyrtar, sic janë diplomat.

Gjatë periudhës aktuale është evidentuar një rritje e ndjeshme e kërkesave për prodhim dokumentacioni specifik, sic janë printimi i diplomave dhe certifikatave.

Ky volum ka sjellë nevojën për rritje të kapaciteteve të printimit dhe prodhimit të dokumentacionit, si dhe për sigurimin e materialeve të nevojshme (letër speciale, elemente sigurie, materiale konsumuese dhe shërbime të specializuara printimi).

Rritja e fondit në 1,058,473 lekë është e nevojshme për të garantuar vazhdimësinë e punës së Sekretarisë, saktësinë e dokumentacionit zyrtar dhe përmbushjen në kohë të detyrimeve institucionale nda studentëve, në përputhje me standardet administrative dhe ligjore në fuqi.

6. Shtesë në RPPP për vitin 2026 nga buxheti në zërin 6021001 "Blerje veshje sportive të loguara UST (Kostume tuta, bluza, kapele)", në shumën 360,000 lekë.

Argumentimi: Shtimi i zërit "Blerje veshje sportive të loguara UST (kostume tuta, bluza, kapele)" në Regjistrin e Prokurimeve lidhet me nevojën për përfaqësim institucional dhe uniformizim të pjesëmarrjes në aktivitetet sportive universitare dhe ndërkombëtare të planifikuara për vitin 2026.

Në vijim të marrëveshjeve institucionale të realizuara pas fillimit të vitit 2026, është konfirmuar organizimi dhe pjesëmarrja e UST-së në një sërë aktivitetesh sportive universitare kombëtare dhe ndërkombëtare, të cilat kërkojnë prezantim zyrtar të ekipit përfaqësues nëpërmjet veshjeve të unifikuara dhe të loguara me identitetin institucional.

Ky element përfaqësimi konsiderohet i domosdoshëm për garantimin e standardeve të protokollit sportiv dhe institucional, si dhe për forcimin e identitetit vizual të UST-së në aktivitetet ku merr pjesë.

Duke qenë se planifikimi fillestar i Regjistrit të Prokurimeve është hartuar përpara finalizimit të kalendarit të detajuar të aktiviteteve sportive për vitin 2026, këto nevoja nuk kanë qenë të parashikueshme në momentin e programimit fillestar, pasi janë rezultat i marrëveshjeve dhe konfirmimeve të mëvonshme institucionale.

Në këto kushte, shtimi i këtij zëri në Regjistrin e Prokurimeve është i justifikuar si një nevojë e krijuar nga zhvillimi i aktiviteteve të paplanifikuara në fazën fillestare, dhe synon të sigurojë pjesëmarrje dinjitoze dhe përfaqësim të unifikuar institucional në eventet sportive ku UST është pjesëmarrës.

7. Shtesë në RPPP për vitin 2026 nga të ardhurat në zërin 2312117 "Shpenzime për terrenet sportive (Rrethimi me rrjetë i fushës së futbollit)", kemi një zë të ri të shtuar, në vlerën 1,200,000 lekë.

Argumentimi: Ky zë është kërkuar nga Fakulteti i Shkencave të Lëvizjes dhe ky shpenzim justifikohet nga detyrimi i institucionit për të garantuar sigurinë, funksionalitetin dhe mbrojtjen e infrastrukturës publike, si dhe për të siguruar përdorimin e saj në mënyrë të qëndrueshme dhe efikase.

Në këtë kuadër, vendosja e rrethimit me rrjetë për fushën sportive përbën një masë të domosdoshme mbrojtëse, e cila:

- parandalon dëmtimin e investimit publik dhe zgjat jetëgjatësinë e infrastrukturës;
- rrit sigurinë e përdoruesve (studentë dhe personel), duke minimizuar rreziqet gjatë përdorimit të terrenit;
- shërben si masë parandaluese për shmangien e dëmtimeve të mundshme.

Gjithashtu, duke qenë se, gjatë vitit 2026 parashikohet vënia në funksion e një terreni të ri sportiv, kjo ndërhyrje merr karakter paraprak dhe strategjik, duke garantuar administrimin e duhur dhe të sigurt të asetit që në momentin e vënies në përdorim.

Realizimi i këtij shpenzimi është i nevojshëm dhe në përputhje me parimet e menaxhimit të mirë të fondeve publike dhe mbrojtjes së investimeve institucionale.

8. Shtesë në RPPP për vitin 2026 nga buxheti në zërin 2313100 "Shpenzime për konstruksione të rrugëve (Shtrim me çakëll i hyrjes së dytë të parkimit pranë sallës së lojrave me dorë)", kemi një zë të ri të shtuar, në vlerën 1,200,000 lekë.

Argumentimi: Ndërhyrja për shtrimin dhe organizimin e hyrje-daljeve të parkimit përbën një element thelbësor të funksionalitetit të infrastrukturës, duke siguruar përmbushjen e standardeve minimale infrastrukturore për institucionet publike.

Nga ana ligjore dhe funksionale, ky investim mbështetet në parimin e dobishmërisë së investimit publik, sipas të cilit infrastruktura nuk konsiderohet e plotë nëse nuk garanton akses të sigurt dhe të përdorshëm për qytetarët dhe përdoruesit.

Në këtë kontekst, realizimi i rikonstruksionit të fushës së futbollit dhe pistës së atletikës ka sjellë ndryshime në konfigurimin funksional të hapësirave ekzistuese. Si rezultat, është krijuar pamundësi për aksesimin e mëparshëm të parkimit, duke e bërë të nevojshme riorganizimin e aksesit dhe krijimin e një daljeje të veçantë për parkimin, me qëllim garantimin e funksionalitetit dhe sigurisë së përdoruesve. Kjo

nevojë vlerësohet si e paparashikueshme në fazën fillestare të hartimit të regjistrit, pasi rrjedh drejtpërdrejt nga ndikimi fizik i investimit të sapopërfunduar.

Në këto kushte, prioriteti i planifikimit të fondeve orientohet drejt ndërhyrjeve që sigurojnë funksionalitetin e plotë të infrastrukturës së krijuar, konkretisht përmirësimin e aksesit në hapësirën e parkimit, si element i domosdoshëm për përdorim normal dhe të sigurt të objektit.

Si rezultat i këtij rishikimi:

- fondet janë rialokuar nga zëra me nevoja të reduktuara, në funksion të vlerësimit teknik aktual;
- është parashikuar shtimi i një objekti të ri në Regjistrin e Prokurimeve, që adreson investimin për sistemimin dhe aksesin e parkimit.

Ky ndryshim synon të sigurojë funksionalitet të plotë të infrastrukturës së re, të shmangë riskun operacional të lidhur me mungesën e aksesit, si dhe të garantojë orientim të fondeve drejt nevojave prioritare dhe të menjëhershme të institucionit.

9. Shtesë në RPPP për vitin 2026 nga buxheti në zërin 2314320 "Mjete dhe pajisje të tjera teknike (Blerje vegla pune)", kemi një zë të ri të shtuar, në vlerën 120,000 lekë.

Argumentimi: Ky zë shpenzimi është i justifikuar në kuadër të nevojave operative të institucionit për sigurimin e pajisjeve dhe veglave bazë të punës, të domosdoshme për kryerjen e ndërhyrjeve të vogla dhe të menjëhershme në mirëmbajtje.


Ky zë shërben për të mbuluar blerjen e veglave të punës që përdoren nga Sektori i Shërbimeve Mbështetëse për realizimin e detyrave të përditëshme dhe ndërhyrjeve emergjente, të cilat nuk kërkojnë procedura të gjata prokurimi, por janë thelbësore për garantimin e funksionimit normal të institucionit.

Në këtë mënyrë, sigurohet vazhdimësia e punës, rritet efikasiteti i ndërhyrjeve në terren dhe shmangen vonesat operative që mund të lindin nga mungesa e pajisjeve bazë të punës.

Parashikimi i këtij zëri është i domosdoshëm për garantimin e funksionalitetit dhe vazhdimësisë së shërbimeve të mirëmbajtjes.

Bashkëlidhur RRPPP me shtesat dhe ndryshimet për vitin 2026

Duke ju falenderuar mbetemi në pritje të miratimit, për të vijuar më tej.



INSTITUCIONI QENDROR : MINISTERIA E ARSIMIT

Autoriteti Kontraktor: Universiteti i Sporteve të Tiranës

Shtesa dhe ndryshime në Regjistrin e Parashikimeve të Prokurimeve Publike viti 2026

Shtesa

Nr	Llogaria	Viti	I ri/ modifi- kuar	Objekti i prokurimit	Kontratë, Marrëveshje kuadër	Tipi i kontratës (mall/pun- ë/shërb- im/marrëv- eshje kuadër)	Fondi/ llogarit	Buxheti (buxheti i shtetit, të ardhura, vetëfinanci- m.etj)	Vlera	Lloji i procedurës se prokurimit/ Marrëveshje/ Amendami- ent kontratë për revojat e fillim-viti	CPV Kod	Koha e planifik- uar për shpalljen e procedur- ës (muajt)	Organi që zëvendëson procedurën e prokurimit në rastin e procedurave të përqëndruara
1	2310140	2026	I ri	Paisje laboratorit, (Titulli i projektit: Laboratori i Diagnostikës dhe Optimizimit të Shëndetit)	Kontratë	Mallra	4,551,833	Buxheti	5,942,200	Tender i hapur i thjeshtuar	38000000-5 33100000-1	Gjatë vitet 2026	UST
Totali								4,551,833	5,942,200				

		Buxheti				Pakesohet							
Nr	Llogaria	Viti	Liri/modifi kuar	Objekti i prokurimit	Kontratë Marrëveshje/kuader	Tipi i kontratës (mall/punë shërbim/marrëveshje/kuader)	Fondi i llogarituar	Buxheti i financimit (buxheti i shtetit, të ardhura, vetëfinancim etj)	Vlera	Lloji i procedurës së prokurimit/Minikontratë/Amendament kontratë për nevojat e filijm.viti	CPV Kod	Koha e planifikuar për shpalljen e procedurës (muajt)	Organi që zhvillon procedurën e prokurimit në rastin e procedurave të përqëndruara
1	6025300	2026	I ri	Shpenzime për mirëmbajtjen e objekteve ndërtimore.	Kontratë	Sherbim	3,200,000	Buxheti	840,000	Prokurim e hapur e thjeshtuar	45332200-5 45410000-4 45442110-1	Gjatë vitit 2026	UST
							Totali	3,200,000	840,000				

		Buxheti				Shohet							
Nr	Llogaria	Viti	Liri/modifi kuar	Objekti i prokurimit	Kontratë Marrëveshje/kuader	Tipi i kontratës (mall/punë shërbim/marrëveshje/kuader)	Fondi i llogarituar	Buxheti i financimit (buxheti i shtetit, të ardhura, vetëfinancim etj)	Vlera	Lloji i procedurës së prokurimit/Minikontratë/Amendament kontratë për nevojat e filijm.viti	CPV Kod	Koha e planifikuar për shpalljen e procedurës (muajt)	Organi që zhvillon procedurën e prokurimit në rastin e procedurave të përqëndruara
1	6020200	2026	I ri	Materiale për pastrim, dezinfektim, për ngrohje dhe ndriçim	Kontratë	Mallra	233,333	Buxheti	280,000	Prokurim me vlera të vogla	39831600-9 39831600-2 39830000-9 39831600-2 33761000-2	Gjatë vitit 2026	UST
2	6021001	2026	I ri	Blerje veshje sportive të leguara UST (Kostumë tuta, bluza, kapele)	Kontratë	Mallra	300,000	Buxheti	360,000	Prokurim me vlera të vogla	18222100-2 18222200-3 18412000-0 18331000-8 18235400-9	Gjatë vitit 2026	UST
3	6021010	2026	I ri	Shpenzime për prodhim dokumentacioni specifik	Kontratë	Mallra	682,061	Buxheti	818,473	Prokurim me vlera të vogla	22160000-9 79811000-2 79800000-2	Gjatë vitit 2026	UST
4	602008	2026	I ri	Sherbime të sigurimit të rruajtjes	Kontratë	Sherbim	984,606	Buxheti	1,181,527			Gjatë vitit 2026	UST
5	6025300	2026	I ri	Shpenzime për mirëmbajtjen e objekteve ndërtimore.	Kontratë	Sherbim	1,000,000	Buxheti	1,200,000	Prokurim me vlera të vogla	45332200-5 45410000-4 45442110-1	Gjatë vitit 2026	UST
							Totali	3,200,000	3,840,000				

H

[Signature]

[Signature]

INVESTIME

Nr.	Llogaria	Viti	I ri / i modifi kuar	Objekti i prokurimit	Kontrate / Marrëveshje / kontrate / kontrate	Tipi i kontratës (mall/punë / shërbim / marrëveshje / kontrate)	Fondi i logarituar	Burimi financiar (bugeti / shërbim / ardhura / veçfinansim)	Pakë: ohet			
									Lloji i procedurës së prokurimit / Mini kontratë / Amendament / kontratë për nevojat e fillim viti	Koha e planifikuar për shpalljen e procedurës (muaji)	Koha e planifikuar për zhvillimin e procedurës së prokurimit në rastin e procedurave të përqëndruara	Organizimi që zhvillon procedurën e prokurimit në rastin e procedurave të përqëndruara
1	2310000	2026	I ri	Rikonstruksione	Kontrate	Pune	2,300,000	Te Ardhura	45210000-2	Gjatë vitit 2026	UST	
							Totali	2,300,000	2,300,000			

Nr.	Llogaria	Viti	I ri / i modifi kuar	Objekti i prokurimit	Kontrate / Marrëveshje / kontrate / kontrate	Tipi i kontratës (mall/punë / shërbim / marrëveshje / kontrate)	Fondi i logarituar	Burimi financiar (bugeti / shërbim / ardhura / veçfinansim)	Shtohet			
									Lloji i procedurës së prokurimit / Mini kontratë / Amendament / kontratë për nevojat e fillim viti	Koha e planifikuar për shpalljen e procedurës (muaji)	Koha e planifikuar për zhvillimin e procedurës së prokurimit në rastin e procedurave të përqëndruara	Organizimi që zhvillon procedurën e prokurimit në rastin e procedurave të përqëndruara
1	2312117	2026	I ri	Shpenzime për terrenet sportive (Rrëtim me rrjete i fushës së futbollit)	Kontrate	Pune	1,000,000	Te Ardhura	45212221-1	Gjatë vitit 2026	UST	
2	2313100	2026	I ri	Shpenzime për konstruksione të rrugëve (Shtrim me çakelli i hyrjes së dytë të parkimit pranë sallës së lojtrave me dore)	Kontrate	Pune	1,000,000	Te Ardhura	45233141-9 45233222-1	Gjatë vitit 2026	UST	
3	2314320	2026	I ri	Mjete dhe pajisje të tjera teknike (Blerje vegla pune)	Kontrate	Mallra	100,000	Te Ardhura	42650000-7 44510000-8 44511000-5	Gjatë vitit 2026	UST	
							Totali	2,000,000	2,000,000			

[Handwritten signature]

[Handwritten signature]

Vlera e kontrates me Illyrian Guard perlogaritur sipas tarifave te Udhezimit nr.90, date 27.06.2023

Nr.	Vendroje	Turne	Koha e sherbimit	Koefic.	Roje	Tarifa mujore pa tvsh	Vlera mujore pa tvsh	Vlera vjetore pa tvsh	Vlera vjetore me tvsh
1	1	3	24 ore/ e hene - e diete	1.66	4.98	87,892.00	437,702.16	5,252,425.92	6,302,911.10
Pagesa mujore e sherbimit									525,242.59

Vlera e kontrates me Illyrian Guard perlogaritur sipas tarifave te Udhezimit nr.70, date 30.03.2026

Nr.	Vendroje	Turne	Koha e sherbimit	Koefic.	Roje	Tarifa mujore pa tvsh	Vlera mujore pa tvsh	Vlera vjetore pa tvsh	Vlera vjetore me tvsh
1	1	3	24 ore/ e hene - e diete	1.66	4.98	109,860.00	547,102.80	6,565,233.60	7,878,280.32
Pagesa mujore e sherbimit									656,523.36
Efekti vjetor i ndryshimit te tarifes							109,400.64	1,312,807.68	1,575,369.22
Efekti per periudhen e mbetur 01.04.2026 - 31.12.2026							109,400.64	984,605.76	1,181,526.91
Vlera e kontrates me Illyrian Guard perlogaritur sipas tarifave te Udhezimit nr.70, date 30.03.2026									7,484,438.02
									7,484,438.02

Eduard Meçaj

